



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

FTESË PËR ANKAND PUBLIK (Dhënia e hapësirave/lokaleve me qira)

1. Dhënia e hapësirave/lokaleve afariste me qira

Në mbështetje të Vendimit me nr.prot.02/3044 datë 10.10.2025, në lidhje me shpalljen e Ankandit Publik, NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësira/lokale afariste për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, sipas kushteve të mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i njësise	Sipërfaqja në m ²	Identifikimi/Numri i lokalit/hapësirës	Çmimi fillestar (PA TVSHË)
1.	Lokal	15m ²	5	375€
2.	Lokal	8.55m ²	18	239.83€
3.	Lokal	19.02m ²	20	381.16€
	Terasë e Brendshme	17.20m ²		25.80€
4.	Lokal	304.73m ²	22	1,797.91€
5.	Lokal/Garazh	572.53m ²	25	2,822.57€
	Lokal	47.84m ²		406.64€
	Terasë e Jashtme/Oborr	400.45m ²		148.17€
	Terasë e Jashtme/Oborr	825.15m ²		305.31€
6.	Tokë	500m ²	33	375€
8.	Sportel	3.15m ²	2	300€
9.	Sportel	3.15m ²	3	300€
10.	Sportel	3.15m ²	4	300€

Shënim: Çmimet janë pa TVSH.

2. Zhvillimi i veprimtarive në hapësirat/lokalet afariste

Sa i përket shfrytëzimit të hapësirës afariste gjatë procesit të ankandit publik, preferencat orientuese për dhënien me qira janë si vijon:

- **Për lokalet nr. 5, 18, 20, 22 dhe 25** preferohet shfrytëzimi i tyre si zyre administrative ose për veprimtari të ngjashme, për kompani autotransportuese apo operatorë ekonomikë, veprimtaria e të cilëve nuk bie ndesh me aktivitetin e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.
- **Për hapësirën afariste të kategorizuar si "Tokë"** preferohet shfrytëzimi i saj për parking të operatorëve transportues, parking për taksì, rent-a-car, apo për veprimtari të tjera që nuk bien ndesh me aktivitetin e ndërmarrjes.
- **Për sportelet nr. 2, 3 dhe 4** preferohet shfrytëzimi i tyre si zyra ose për veprimtari të ngjashme për kompanitë autotransportuese, veprimtaria e të cilave nuk bie ndesh me aktivitetin e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.

Të drejtë pjesëmarrjeje në këtë procedurë kanë vetëm personat juridik, të cilët obligohen të paraqesin si dëshmi certifikatën e regjistrimit të biznesit.

3. Dokumentet e domosdoshme për pjesëmarrje në ankand:

- **Kopja e Certifikatës së Regjistrimit të Biznesit me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe numri fiskal me të dhënat përkatëse;**
- **Kopja e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;**
- **Oferta financiare – çmimi për qiranë mujore (pa TVSH);**
- **Të dhënat e arkës fiskale;**
- **Vërtetim nga ATK që dëshmon se biznesi është aktiv;**
- **Përshkrimi i veprimtarisë që do të ushtrohet në hapësirën afariste, si dhe**
- **Adresa e email-it të personit/biznesit përmes së cilës do të zhvillohet komunikimi zyrtar ndërmjet palëve.**

4. Kushtet dhe obligimet tjera

Pjesëmarrësit në këtë procedurë të ankandit publik janë të detyruar të dorëzojnë të gjitha dokumentet e domosdoshme të kërkuara sipas listës së përcaktuar më lart. Përveç dokumenteve të detyrueshme për dorëzim, pjesëmarrësit duhet të respektojnë edhe kushtet e mëposhtme, të cilat rregullojnë mënyrën e aplikimit, afatet dhe detyrimet pas shpalljes së rezultatit.

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand përjashtohen të gjithë debitorët që kanë obligime të pashlyera ndaj NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.
- Ndërmarrja nuk do të japë në shfrytëzim hapësirat afariste bizneseve të peregjistruara, si dhe atyre që ushtrojnë veprimtari në kundërshtim me reputacionin dhe interesat e ndërmarrjes.
- Kriteri themelor për dhënien e kontratës është oferta me çmimin më të lartë.
- Të gjitha palët e interesuara kanë mundësi ta inspektojnë hapësirën/lokalin çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është i përcaktuar deri më **27.10.2025**, ora 14:00, ndërsa hapja e tyre do të bëhet po atë ditë, në ora 14:30, në hapësirat e ndërmarrjes.
- Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura në zarfe dhe të protokolohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Në hapjen e ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë ofertuesit.
- Subjekti i shpallur fitues është i obliguar që brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga njoftimi se i njëjti është shpallur fitues, të e nëshkruaj kontratën për qiradhënie.

5. Të tjera

Dhënia me qira e hapësirave afariste bëhet për një periudhë një (1) vjeçare, me mundësi vazhdimi, në përputhje me rregulloren e brendshme që rregullon lëshimin e hapësirave afariste dhe vendosjen e objekteve të përkohshme.

Për informata më të hollësishme, palët e interesuara mund të kontaktojnë në adresën elektronike contact@sap-rks.com ose në numrin e telefonit 038 551 333.